



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 22, datë 20.07.2022

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT SË ZONJËS HOLTA ZAÇAJ NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË, DATË 16.01.2017 DHE TË RISHPALLUR NË DATAT 03.06.2021 DHE 31.01.2022

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare, relatore
Elsa Toska	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Anila Leka	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Genti Xholi	Anëtar
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Mema	Anëtare

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu.

Me praninë e Avokates së Popullit, Znj. Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: Z. Bledar Dervishaj, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës dhe Znj. Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kuvendit të Republikës, në mbledhjen e datës 20.07.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATES: Holta Zaçaj

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar, në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 16.01.2017, 03.06.2021, rishpallur në datë 31.01.2022.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e Zëvendëskryetares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, njëkohësisht relatore, Znj. Marsida Xhaferllari, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, Znj. Erinda Ballanca, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe, si e bisedoi çështjen në tërësi,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Lartë, në datën 16.01.2017, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e plotë, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtares Vitore Tusha. Hapja e procedurës është shpallur në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000).

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (në vijim KED), duke mos u plotësuar numri i kandidatëve për këtë vend vakant, me vendimin nr. 6, datë 05.04.2019, ka vendosur: “Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur”, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.

3. Gjykata e Lartë ka rishpallur, në datën 19.04.2019, hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant, në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000.

4. Ndodhur në kushtet e mungesës së kandidaturave, më datën 03.06.2021, Gjykata e Lartë, me të njëjtën bazë ligjore, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant. Pas përfundimit të afatit, kjo Gjykatë i ka dërguar KED një listë të dytë të kandidatëve, që i ishin përgjigjur rithirrjes së saj, të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore.

5. Në vijim, KED në mbledhjen e datës 12.07.2021 vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 05.04.2019, “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”, si dhe rifillimin e procesit të shqyrtimit të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

6. KED, duke qenë se numri i kandidatëve ra nën tre, me vendimin nr. 31, datë 22.12.2021, ka vendosur pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.

7. Në datën 31.01.2022, Gjykata e Lartë, me të njëjtën bazë ligjore, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant. Pas përfundimit të afatit, kjo Gjykatë i ka dërguar KED listën e kandidatëve, që i ishin përgjigjur rithirrjes së saj, të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, në të cilën përfshihej kandidatja Holta Zaçaj, e cila kishte aplikuar në datën 28.02.2022.

8. Në mbledhjen e datës 15.03.2022, KED realizoi procedurën e shortit manual për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 115/2016), pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED, nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja Marsida Xhaferllari, ndërsa këshilltare ligjore Edlira Llango.

9. Kandidatja Holta Zaçaj, në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, është njoftuar me shkrim për t'u paraqitur për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim datë 16.03.2022, është kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja, si dhe gjendet i administruar në dosjen e kandidatës.

10. Në datën 17.03.2022, përfaqësuesja me prokurë e kandidatës është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të KED-së dhe ka tërhequr formularët e deklaratave, autorizimeve dhe informacioneve të përcaktuara sipas ligjit nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 4/2019 të KED-së.

11. Në datën 21.03.2022, kandidatja ka depozituar në sekretarinë e KED-së (nëpërmjet shërbimit postar) formularët e deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës. Për këtë arsye është mbajtur edhe procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit, i regjistruar me nr. 332 prot., datë 23.03.2022, i nënshkruar nga punonjësi i administratës së KED-së.

12. Në datën 29.03.2022, nëpërmjet formës elektronike të njoftimit (i cili është i administruar në dosje), KED ka njoftuar kandidaten në lidhje me vijimin e procedurave të verifikimit, duke i bërë me dije se: *"...Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ju vë në dijeni se ka dërguar listën e kandidatëve dhe personave të lidhur, pranë ILDKPKI, për vijimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe interesave private, sipas sistemit EACIDS"*.

13. Në kushtet, kur kandidatja Holta Zaçaj kishte aplikuar edhe për vendet vakante të tjera, procedura e verifikimit të të cilave kishte filluar më parë, relatorja Marsida Xhaferllari, me urdhrin nr. 2, datë 06.04.2022 urdhëroi:

1. Marrjen dhe administrimin në dosjen e kandidimit të znj. Holta Zaçaj..... kopje të akteve që janë pjesë e verifikimit për plotësimin e kushteve të tjera ligjore nga ato të parashikuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të cilat ndodhen në dosjet e secilës prej tyre për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 13.01.2022 dhe vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 15.11.2021. 2. Memoja e datës 06.04.2022 i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

I. Verifikimi i kushteve

1. Shtetësia dhe zotësia për të vepruar

14. Neni 7/a pika 1 shkronja "a" e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar.

15. Kandidatja Holta Zaçaj rezulton me shtetësi shqiptare, të konfirmuar nga letërnjoftimi ID, në të cilën përmbahet numri personal H65112129V. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që kësaj kandidate t'i jetë hequr apo t'i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

2. Arsimi

16. Neni 125 pika 4 e Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1 shkronja "b" e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi "arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë".

17. Kandidatja ka kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ajo është diplomuar "Jurist", e pajisur me Diplomën nr. 4905, nr. 2926 regi., datë 18.07.1998. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ky lloj arsimimi kualifikohet arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

3. Përvoja profesionale

18. Neni 125, pika 4 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 2 e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi përvojën e punës prej të paktën prej 15 vjet në detyrën e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës, si dhe të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

19. Nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidatja dhe nga deklarimi i saj në jetëshkrim, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka përvojë profesionale për më shumë se 15 vjet në profesionin e avokates. Konkretisht, ajo ka ushtruar veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

a) Avokate, për periudhën Janar 2020 e në vijim, pranë Zyrës së Avokatisë "Zaçaj Laë PC". Anëtare e Komitetit për Shërbimet e Mbrojtësit Publik – Divizioni për fëmijët dhe familjen në shtetin e Massachusetts, SHBA.

b) Avokate, për periudhën Maj 2019 – Janar 2020, pranë Ligris and Associates PC, SHBA.

c) Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Ligjore, për periudhën Maj 2013 – Tetor 2018, pranë Alpha Bank Albania SHA. Përgjegjësitë e kryera: konsulente ligjore pranë Bordit të Drejtorëve, mbrojtja e interesave të Bankës (avokat i bankës), përgjegjës për hartimin e të gjitha kontratave të bankës.

ç) Avokat/Partner, për periudhën Korrik 2008 – Prill 2013 dhe Janar 2019 e në vazhdim, pranë "Delegibus COUNSULTING", firmë ligjore.

d) Pedagoge e jashtme/specialiste, Viti akademik 2009-2013, pranë Shkollës së Magjistraturës.

dh) Trajnues, Viti akademik 2010-2011, pranë Shkollës së Magjistraturës.

e) Trajnues, Viti akademik 2009-2010, pranë Shkollës së Magjistraturës.

ë) Trajnues, Viti akademik 2008-2009, pranë Shkollës së Magjistraturës

f) Pedagoge me kohë të pjesshme¹, Viti akademik 2013-2014, pranë Universitetit Luarasi.

g) Pedagoge e jashtme², Viti akademik 2009-2010, pranë Universitetit Europian të Tiranës.

gj) Avokate/Drejtore ekzekutive, Gusht 2002 – Maj 2007, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI).

h) Bashkëdrejtore, 1999-2002, pranë Qendrës Paqe nëpërmjet Drejtësisë (Kandidatja referon se subjekti është mbyllur, nuk është më aktiv).

¹ Sipas shkresës së këtij universiteti të paraqitur në KED nga vetë kandidatja.

² Sipas shkresës së këtij universiteti të paraqitur në KED nga vetë kandidatja.

20. Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., kandidatja Holta Zaçaj ka deklaruar se ka qenë autore/bashkëautore/kontribues dhe kërkuese shkencore në një sërë publikimesh profesionale dhe kërkimesh shkencore, ka disa kualifikime pasuniversitare, ka marrë pjesë në trajnime, si dhe është vlerësuar me çmime të ndryshme.

21. KED ka kërkuar informacion pranë institucioneve publike dhe subjekte private, në të cilat kandidatja Holta Zaçaj ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit, të cilat përshkruhen më poshtë.

22. Me shkresën nr. 414 prot., datë 01.04.2022 i është kërkuar informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 192 prot., datë 8.4.2022, duke informuar se: *Zonja Holta Zaçaj është avokate dhe mban licencën e avokatisë me nr. 2461. Ka ushtruar profesionin e avokatit prej vitit 2005 e në vazhdim. Zonja Zaçaj nuk ka detyrime financiare ndaj subjektit tonë dhe ndaj saj nuk janë marrë masa disiplinore;*

23. Me shkresën nr. 415 prot., datë 01.04.2022 i është kërkuar informacion Bankës Alpha Albania SHA, e cila, me shkresën nr. 15653 prot., datë 05.4.2022, ka informuar se: *periudha e punësimit në Alpha bank është 8.4.2013 – 31.10.2018. pozicioni i punës ka qenë Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Ligjore. Znj. Holta Zaçaj nuk ka qenë asnjëherë subjekt i masave disiplinore. Vlerësimi profesional për Znj. Holta Zaçaj për vitet e punësimit pranë Alpha Bank Albania SHA, ka qenë maksimal;*

24. Me shkresën nr. 419 prot., datë 07.04.2022 i është kërkuar informacion Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), e cila, me shkresë të datës 22.4.2022, ka informuar se: *punësimi i Znj. Zaçaj pranë QSHPLI ka qenë Drejtore Ekzekutive nga data 7 prill 2004 deri në 16 Prill 2007, gjatë kësaj periudhe, duke filluar nga data 16.7.2005 Znj. Zaçaj ka punuar edhe si avokate pranë QSHPLI. Zonja Zaçaj përgjatë periudhës kohore viti 2013 e në vazhdim ka vazhduar të angazhohet pranë QSHPLI si avokate për dhënien e ndihmës falas për grupet vulnerabile që Qendra ka asistuar. Znj. Zaçaj nuk ka marrë masa disiplinore;*

25. Me shkresën nr. 420 prot., datë 11.04.2022, i është kërkuar informacion shoqërisë De Legibus Consulting SHPK, e cila, me shkresë të datës 20.4.2022, ka informuar se: *punësimi i Znj. Zaçaj pranë shoqërisë De Legibus Consulting SHPK ka qenë me kohë të plotë nga periudha Korrik 2008 deri në Mars 2013. Përgjatë kësaj periudhe janë derdhur rregullisht kontributet. Pozicioni i ushtruar ka qenë Avokate dhe Juriste e shoqërisë De Legibus Consulting SHPK. Zonja Zaçaj ka vazhduar të mbetet si avokate e asociuar pranë firmës ligjore De Legibus Consulting SHPK gjatë periudhës Mars 2013 e në vazhdim. Ajo punon si avokate me honorare apo kontrata të veçanta shërbimi, duke derdhur pranë zyrës kontribute sipas rastit. Znj. Zaçaj nuk ka marrë masa disiplinore.*

26. Me shkresat nr. 426 prot., datë 22.4.2022 dhe 455 prot., datë 23.5.2022, KED ka kërkuar dhe për shkak të vonësës në përgjigje ka rikërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimore (DRT) Tiranë. DRT Tiranë, me shkresën nr. 8460/1, datë 30.5.2022 (në përgjigje të shkresës KED 426 prot., datë 22.4.2022, ka bërë me dije se: *për Holta Vladimir Zaçaj me nr. personal H65112129V, në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe funksionin/profesionin” për periudhën e punësimit, referuar të dhënave në sistemin tonë tatimor dhe në mbështetje të të dhënave*

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të deklaratës së "Listëpagesës së Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi", të deklaruara nga subjektet ju informojmë si më poshtë vijon: 1. Për periudhën e punësimit 1.12.2011-9.3.2013 në subjektin Deleghus Consulting me NIPT K81924011V, rezultoi e deklaruar me funksion/profesion "Jurist". 2. Për periudhën e punësimit 8.4.2013-31.10.2018 në subjektin Banka Alpha Albania me NIPT J72311006R, rezultoi e deklaruar me funksion/profesion "Drejtor Shërbimesh financiare". 3. Për periudhën e punësimit 10.12.2013-1.11.2014 në subjektin Universiteti Luarasi me NIPT K31526058G, rezultoi e deklaruar me funksion/profesion "Pedagog universiteti". Në sistemin tatimor, mbarten të dhëna në lidhje me listëpagesat dhe formularët e ndryshimit të punonjësve të subjekteve, duke filluar nga periudha tatimore Dhjetor 2011 e në vijim. Për sa më lart, çdo informacion me datë më të hershme nuk administrohet nga administrata tatimore.

4. Funksionet politike

27. Neni 125, pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1 shkronja "c" i ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë dhjetë viteve të fundit nga data e kandidimit.

28. Kandidatja ka kandiduar në datën 28.02.2022 dhe, për pasojë, verifikimi është realizuar për periudhën 10 vjeçare "28.02.2012 –28.02.2022".

29. Sa i takon *ushtrimin të funksionit politik*, duke iu referuar të dhënave të punësimit të kandidatës dhe pozicioneve të punës, nuk rezultoi që kandidatja të gjendet në kushtet e këtij ndalimi.

30. Sa i takon *pozicioneve drejtuese në partitë politike*, KED në datat 23.03.2022, 30.03.2022 dhe 31.05.2022, i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Duhet evidentuar fakti se pjesa më e madhe e partive politike nuk kanë kthyer përgjigje. Kanë kthyer përgjigje gjithsej 5 parti politike, të cilat konfirmojnë në thelb se "në 10 vitet e fundit, kandidatja nuk ka mbajtur funksione drejtuese apo të ketë qenë anëtare partie".

31. KED me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, vendosi "Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit". Ky vendim hyri në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Në vijim, në datë 02.03.2022 është njoftuar me e-mail kandidatja të paraqesë këtë formular të plotësuar, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e këtij njoftimi. Kandidatja në datë 07.03.2022 ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike.

5. Integriteti

32. Neni 125, pika 5 i Kushtetutës parashikon se kriteret e tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a, pika 1, shkronjat "ç" dhe "d" të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë kushtet e kandidimit që kandidati: "ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale" dhe "d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi". Neni 236 i ligjit nr. 115/2015 dhe ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 138/2015), përcaktojnë që kandidati duhet të mos jetë i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të mos ketë pasur masë sigurimi personal ose urdhër dëbimi, për një listë veprash penale të parashikuara shprehimisht nga ligji. Ndërsa neni 29 i ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” përcakton si kusht ndalues kandidimi nëse kandidati ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, bashkëpunëtor aktiv i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe nëse figuron ose jo në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

33. Lidhur me verifikimin e të dhënave të dekriminalizimit, KED, në bazë të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikës 82 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 337 prot., datë 29.03.2022 ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, për kompetencë verifikimi formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja sipas ligjit nr. 138/2015. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 439/1 prot., datë 04.04.2022 informon KED që Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion të plotë në lidhje me kërkesat e shkresës së KED, pranë prokurorive të rretheve dhe do ia vërë në dispozicion. Gjithashtu bashkëlidhur shkresës gjendet vendimi i Drejtorisë së Koordinimit Institucional pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me të cilin është vendosur:

“Mospranimi i kërkesës nr. 337 prot., datë 29.03.2022 për kryerjen e verifikimit të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit datë 18.03.2022, për personin Holta Zaçaj, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

34. Duke veçuar përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (të cituar në vijim), Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallë së Parë, pranë Gjykatës së Apeleve dhe SPAK, kanë kthyer përgjigje nga të cilat ka rezultuar se ndaj kandidates Holta Zaçaj, nuk ka kallëzime/procedime penale.

35. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. 3109/1 prot, datë 16.03.2022, në lidhje me kandidaten Holta Zaçaj, ka bërë me dije KED se:

“Ndaj shtetases Holta Vladimir Zaçaj, e datëlindjes 12.1.1976, është regjistruar kallëzimi penal nr. 4207, viti 2015, për të cilin është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal më datë 15.5.2015, si dhe procedimi penal nr. 7616, viti 2019, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim më datë 14.5.2019.”.

36. Në lidhje me procedimet penale nr. 4207, viti 2015 dhe nr. 7616, viti 2019, KED, me shkresën nr. prot. 458, datë 23.05.2022, ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me shkresën nr. 1394 prot., datë 07.06.2022, ka kthyer përgjigje, se:

“Pas verifikimeve të bëra në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për periudhën 2015 – 2022, lidhur me shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, nuk rezulton të ketë pasur ankim për vendimin e mosfillimit të procedimit penal me nr. 4207, të vitit 2015. Në lidhje me procedimin penal nr. 7616, të vitit 2019, bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin nr. 2756 akti, datë 25.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”.

37. Nga shqyrtimi i vendimit nr. 2756 akti, datë 25.6.2019 konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pushimin e procedimit penal nr. 7616 regjistruar pranë prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 1.10.2018, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga*

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

neni 248 i Kodit Penal.”. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk u ankimua. më datë 31.7.2019.

38. Lidhur me verifikimin e të dhënave të dekriminalizimit, KED, në bazë të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikës 82 të vendimit nr. 4/2019 të KED, me shkresën nr. 404 prot., datë 30.03.2022, ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, për kompetencë verifikimi formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja sipas ligjit nr. 138/2015. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 669/1 prot., datë 06.04.2022, informon Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si vijon:

“Në përgjigje të kërkesës për informacion nëse nga ana jonë disponohen të dhëna për dënime penale nga autoritetet gjyqësore të huaja/masa sigurimi personal caktuar nga autoritetet e huaja /shpallur në kërkim ndërkombëtar/procedime penale të regjistruara jashtë territorit të Shqipërisë, për shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, ju informojmë se nga verifikimet e kryera nga Zyra e Protokoll Arkivës dhe në sistemin IMPRO, nuk disponojnë të dhëna. Lidhur me kërkesën nëse këta shtetas, kanë patur identitet të ndryshëm nga ai që mbajnë aktualisht, ju informojmë se ky informacion nuk disponohet nga ana jonë”.

39. Gjithashtu, për verifikimin e integritetit, të lidhur me pastërtinë e figurës dhe të gjendjes gjyqësore të kandidatës, në zbatim të shkronjës “ç”, të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të vendimit nr. 4/2019, KED i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr. 373 prot., datë 30.03.2022); me kërkesë për informacion Shërbimit të Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 372 prot., datë 30.03.2022); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (shkresa nr. 374 prot., datë 30.03.2022); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (shkresa nr. 375 prot., datë 30.03.2022).

40. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1202 prot., datë 14.04.2022, ka bërë me dije se kanë dërguar informacion me shkresën nr. 820, datë 16.3.2022. Rezulton se me shkresën nr. 820 prot., datë 16.3.2022, kjo drejtori ka informuar se: *“Në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e Znj. Holta Vladimir Zaçaj, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.”.*

41. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 616/1 prot., datë s'ka (protokolluar në KED nr. 371/1 datë 04.04.2022), nga ku rezulton se kandidatja Holta Zaçaj: *“nuk figuron e evidentuar për veprimtari kriminale dhe as lidhje e personave me precedent kriminal.”.*

42. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 3757/1 prot., datë 05.04.2022, është përgjigjur se: *“rezulton e padënuar nga gjykata penale shqiptare.”*

43. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 3242/1 prot., datë 07.04.2022, është përgjigjur se: *“Më datë 22.5.1996, me martesë shtetasja ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile nga “Zaçaj”, në “Kotherja”. Më datë 25.7.2009, me divorc merr përsëri mbiemrin “Zaçaj”.*

44. Lidhur me masat disiplinore, KED vlerësoi t'i drejtohet me kërkesë për informacion institucioneve mbështetur në të dhënat në dosjen e kandidatës lidhur me veprimtarinë profesionale të

kandidates si Dhomës Kombëtare të Avokatisë (shkresa nr. 414 prot., datë 1.4.2022), punëdhënësve të kandidates si Bankës Alpha Albania SHA (shkresa nr. 415 prot., datë 1.4.2022), Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) (shkresa nr. 419 prot., datë 7.4.2022), De Legibus Consulting SHPK (shkresa nr. 420 prot., datë 11.4.2022). Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (shkresa nr. 192 prot., datë 8.4.2022), Banka Alpha Albania SHA (shkresa nr. 15653 prot., datë 5.4.2022), Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) (shkresa e datës 22.4.2022), De Legibus Consulting SHPK (shkresa e datës 20.4.2022). Në përmbajtje të përgjigjeve, këto institucione kanë informuar mbi periudhat e punësimit të kandidates, kanë deklaruar pozicionet e punës konkrete, si dhe kanë konfirmuar faktin se kandidatja nuk ka marrë dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

45. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 338 prot., datë 29.03.2022, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Holta Zaçaj për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Ky Autoritet, me shkresën nr. 478/3 prot., datë 15.04.2022, ka dërguar vendimin nr. 120, datë 11.04.2022, me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Holta Zaçaj, duke ardhur përfundimet se: *“Zonja Holta Vladimir Zaçaj nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish Sigurimit të Shtetit; nuk figuron të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të saj, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.”*

6. Pasuritë

46. Neni 125 pika 5 i Kushtetutës parashikon se kritere të tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a pika 1 shkronja “dh” e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi kalimin me sukses nga kandidati të procesit të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

47. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të vendimit nr. 4/2019, KED i ka dërguar ILDKPKI-së nëpërmjet shkresës me nr. 336 prot., datë 29.03.2022, listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 8577/2000 dhe ligjit nr. 115/2016.

48. Në datën 29.03.2022, nëpërmjet formës elektronike të njoftimit (i cili është i administruar në dosje), KED ka njoftuar kandidaten në lidhje me vijim e procedurave të verifikimit, duke i bërë me dije se: *“...Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ju vë në dijeni se ka dërguar listën e kandidatëve dhe personave të lidhur, pranë ILDKPKI, për vijimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe interesave private, sipas sistemit EACIDS”*.

49. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 1212/1 prot., datë 09.05.2022, ka dërguar pranë KED-së. Aktin Përfundimtar nr. 676/23, datë 27.4.2022 dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Holta Zaçaj, ku në përfundim të analizës së hollësishme financiare konkludon se:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- ç) Nuk ka kryer deklaram të rremë.
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

50. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 të vendimit nr. 4/2019 të KED, janë kryer nga KED veprime të tjera verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Holta Zaçaj dhe personave të lidhur me të. Konkretisht, KED, në datat 02.03.2022, 30.03.2022, 23.05.2022 dhe 27.05.2022 i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatës). si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka OTP, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing SHA, (3) Capital Invest SHA, (4) Easypay SHPK, (5) Final SHPK, (6) Fondi Besa SHA, (7) Iutecredit Albania SHA (8) Landeslease SHA, (9) M – Pay SHPK (10) NOA SHA, (11) Porsche Leasing SHA, (12) Posta Shqiptare SHA, (13) Raiffeisen Leasing SHA, (14) Tirana Factoring & Lease SHA, (15) Tranzit SHA, (16) Union Financiar Tiranë, (17) Agrokredit SHA.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, (9) ABI INVEST SHA, (10) ALBSIG INVEST, (11) Credins Invest SHA-Shoqëri Administruese e Fondeve, (12) Raiffeisen Invest Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA, (13) ËVP Fund Management Tirana SHA.
- ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), (2) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), (3) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), (4) Ministrisë së Drejtësisë (MD), (5) Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) SHA, (6) Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), (7) Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT) SHA.

51. Në përgjigje të kërkesave për informacion, institucionet publike dhe subjektet private të listuara më sipër kanë dërguar përgjigjet përkatëse, ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten dhe personat e lidhur me të. Nga përgjigjet e administruara rezultojnë se UKT, me shkresën nr. K-372/1 prot., datë 4.3.2022, ka bërë me dije se: *“Në emër të Znj. Holta Vladimir Zaçaj rezultojnë kontrata nr. 154109-1, për objektin me adresë: “Vaso Pasha”, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve privatë, me detyrime të palikujduara me vlerë 276,432.00 lekë. Nga kontrolli në arkivën e UKT SHA, disponojmë kontratë shitje pasurie të paluajtshme (me kusht), dokumentin e identifikimit ID. Në*

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

emër të Z. Erjon Rakip Duraj rezulton kontrata: nr. 874496-1 për objektin me adresë: "Farkë, Fshati Lundër-Kompleksi Toskany", me status "aktiv", në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të palikujduara me vlerë 17,665.20 lekë. Nga kontrolli në arkivën e UKT SHA, disponojmë: certifikatë për vërtetim pronësie, kartela e pasurisë së paluajtshme, dokumentin e identifikimit ID".

52. Lidhur me të dhënat e dërguara nga UKT, të cilat iu dërguan kandidatës me e-mail, kandidatja Holta Zaçaj, ka sqaruar se: Për kontratën e nr. 154109-1, që i përket objektit me adresë: "Vaso Pasha", me status "aktiv" në kategorinë e konsumatorëve privatë, detyrimet e palikujduara me vlerë 276,432.00 lekë i takojnë Roland Caushaj, pronarit të mëparshëm të pronës dhe jo mua. Detyrimi i vetëm, që më takon mua, është për muajin Qershor 2022 në masën 20760.00 ALL dhe do të paguhet brenda afatit nga qiramarrësi, i cili ka marrë me qira pronën. Erjon Rakip Duraj rezulton kontrata: nr. 874496-1 për objektin me adresë: "Farkë, Fshati Lundër-Kompleksi Toskany". Në mbështetje të kësaj përgjigjeje, kandidatja ka dërguar bashkëlidhur me e-mail në KED, faturat/ekstraktin e marrë nga UKT dhe mandat arkëtimin për pagesën e detyrimit më datë 5.7.2022.

II. Përfundimi i verifikimit nga relatori

53. Në datën 12.07.2022, relatorja ka përgatitur relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar për verifikimin e kandidatës për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017 dhe të rishpallur në datat 03.06.2021 dhe 31.01.2022. Ky akt, iu dërgua përmes e-mailit, Kryetarit të KED nga relatorja, me datë 13.07.2022 për përfshirje në rend dite dhe iu paraqit për shqyrtim dhe vendimmarrje mbledhjes së KED.

54. Gjithashtu, pas komunikimit me kryetarin e KED dhe caktimit të mbledhjes, kandidatës Holta Zaçaj iu njoftua në rrugë elektronike koha e zhvillimit të mbledhjes, duke i dërguar edhe kopje e relacionit. Njoftimi i saj u realizua në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së dhe një kopje e njoftimit administrohet në dosjen e kandidatës.

55. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatorja mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet e çështjes, iu dërguan edhe Avokates së Popullit. Kopje e këtij njoftimi administrohet në dosjen e kandidatës.

56. Koha e zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidatën Holta Zaçaj iu njoftuan edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED. Kopje e këtyre njoftimeve administrohen në dosjen e kandidatës.

57. Gjithashtu, dita dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës u publikuan në faqen zyrtare elektronike të Gjykatës së Lartë, në rubrikën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

58. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të çështjes nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e tjerë të KED, kjo e fundit dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Holta Zaçaj.

59. Në thelb, Avokati i Popullit shprehu qëndrimin se veprimet verifikuese ishin të plota, se vetë Avokati i Popullit ishte njoftuar rregullisht për aktet e mbledhura dhe se nuk ka vërejtje për procedurën e ndjekur.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Sbqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

IV. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

60. KED, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidatit Holta Zaçaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017 dhe të rishpallur në datat 03.06.2021 dhe 31.01.2022.

61. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”.

62. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

63. Duke iu referuar rezultateve të verifikimit të përshkruara në pjesën hyrëse në pikat 15-48 të këtij vendimi, KED arrin në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit që lidhen me shtetësinë, zotësinë për të vepruar, arsimin, përvojën profesionale, integritetin dhe pasurinë.

64. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, KED në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit për kandidatet Holta Zaçaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën datë 16.01.2017 dhe të rishpallur në datat 03.06.2021 dhe 31.01.2022

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si edhe pikave 8, 28, 31, 78, të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, të KED, "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, KED,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Holta Zaçaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017 dhe të rishpallur në datat 03.06.2021 dhe 31.01.2022.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Holta Zaçaj.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINA

